


# INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT



## BULETIN

*(Përmbledhje e shkurtër nga Raporti Vjetor 2011)*

**Gusht 2012**



### ***Avokati i Popullit, Sami Kurteshi***

Avokati i Popullit është institucion i pavarur, i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Misioni ligjor dhe kushtetues i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut. mundëson krijimin e pasqyrës së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë, përfshirë dhe shkallën e shkeljes së tyre.


Shkelja parimeve të drejtësisë ligjore krijon humbjen e baraspeshës së bazuar në drejtësi për të gjithë, e në këtë mënyrë prek në besimin e domosdoshëm për funksionimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Moszbatimi i ligjit është indikator kryesor për humbjen e besimit të qytetarit në institucionet shtetërore. Kjo nuk duhet lejuar të ndodhë, sepse barazinë para ligjit duhet ta sigurojnë dhe ta garantojnë, në radhë të parë mekanizmat shtetërorë.

Avokati i Popullit nuk ndan drejtësi, por evidenton dhe nxjerrë në pah veprimet apo mos veprimet e parregullta e të paligjshme të autoriteteve publike, pikërisht për të luajtur rolin që ka në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin se të gjithë janë të barabartë para ligjit.

## MISIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

*Mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të individëve, nga veprimet e paligjshme ose mosveprimet e autoriteteve publike në Republikën e Kosovës, përbëjnë segmentet kryesorë veprues, përmes të cilëve synohet realizimi i misionit kushtetues dhe ligjor të Avokatit të Popullit.*

*Avokati i Popullit  
i paraqet Raport  
vjetor Kuvendit të  
Republikës së  
Kosovës.*



### **Kush mund të ankohet te Avokati i Popullit?**

***Çdo person fizik apo juridik I cili pretendon se të drejtat apo liritë e tij janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim të kundërligjshëm, keqadministrim të organeve shtetërore, organeve të tjera dhe organizatave që ushtrojnë autoritet publik për llogari të tyre, mund të paraqesë ankesë në IAP për fillimin e procedurës.***

### **Cilat ankesa nuk shqyrtohen nga Avokati i Popullit?**

***Avokati i Popullit nuk mund t'i shqyrtojë ankesat kundër personave privatë (përveç atyre që kanë të bëjnë me pohimet për diskriminim); ankesat kundër vendimeve të gjykatave; ankesat kundër autoriteteve jashtë Kosovës, si dhe ankesat në rastet kur palët nuk i kanë shfrytëzuar mjetet e mundshme juridike.***

### **Kontakti me Avokatin e Popullit dhe parashtrimi i ankesës?**

***Çdo qytetar mund të parashtrijë ankesë në zyrën qendrore dhe në zyrat rajonale, të Institucionit të Avokatit të Popullit, në këtë mënyrë:***

- ***Duke u paraqitur personalisht në njërin nga zyrat e IAP-së;***
- ***Duke e mbushur formularin përkatës;***
- ***Nëpërmjet linjës urgjente të telefonit të IAP-së (pa pagesë);***
- ***Nëpërmjet faksimileve (me telefaks);***
- ***Nëpërmjet postës elektronike (me e-mail);***
- ***Në ndonjë mënyrë tjetër.***

## Përmbledhje statistikore

<b>ANKESAT E PRANUARA 1.1.2011 – 31.12.2011</b>	<b>1453</b>
<b>Përkatësia etnike e ankuesve</b>	
Shqiptarë	1284
Serbë	87
Boshnjakë	39
Romë	18
Turq	16
Të tjerë	9
<b>Gjinia</b>	
Meshkuj	1099
Femra	354

<b>Raportet, letër rekomandimet se edhe kërkesat për masa të përkohshme</b>	
Raporte mbi rastet	5
Raporte <i>ex officio</i>	4
Letër rekomandime	2
Kërkesë për masë të përkohshme	1


<b>Përkatësia etnike e ankuesve, bazuar në ankesat e hetuara</b>	
Shqiptarë	471
Serbë	39
Boshnjakë	14
Turq	9
Romë	8
Të tjerë	5
<b>Gjinia</b>	
Meshkuj	414
Femra	132

<b>Palët përgjegjëse të rasteve të hetuara</b>	
Gjykatat	193 (31 %)
Ministritë	141 (23 %)
Komunat	107 (17 %)
Ndërmarrjet publike	35 (6%)
Policia	28 (5%)
Të tjera	84 (18 %)

## Përmbledhje statistikore

### Rastet e hetuara

1.1.2011 -31.12.2011




■ Rastet e hapura për hetim (nga ankesat e pranuar) 546

■ Rastet e hapura ex officio 13

### 269 raste të mbyllura

1.1.2011 - 31.12.2011



■ Rastet e zgjidhura pozitivisht 162

■ Rastet e papranueshme 86

■ Arsye të tjera 21

## LËNDA E RASTEVE TË HETUARA

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	111
E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	102
Mbrojtja e pronës	81
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	81
E drejta për mjete juridike	76
Barazia para ligjit	21
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	18
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	14
Të drejtat e fëmijës	13
E drejta për arsimin	12
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	11
E drejta e qasjes në dokumente publike	10
Raste për ndërmjetësim	8
E drejta e lirisë dhe sigurisë	7
E drejta e martesës dhe familjes	7
Të drejtat e të akuzuarit	5
Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore	5
E drejta për jetën	4
Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë	4
Dinjiteti i njeriut	3
Liria e lëvizjes	3
Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut	3
Shërbimet e mira	2
E drejta e integritetit personal	1
E drejta e privatësisë	1
Konfesionet fetare	1
Liria e tubimit	1
Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	1
Liria e artit dhe e shkencës	1


## Buxheti dhe shpenzimet për periudhën

1 janar - 31 dhjetor 2011

<i>Kategoritë ekonomike</i>	Buxheti final më 2011	Mjete të paalokuara	Buxheti i shpenzuar	Mjete të pashlyera	Mjete të lira	Realizimi në %
Paga dhe mëditje	361,080.00	-	314,118.00	-	46,961.87	86.99 %
Mallra dhe shërbime	229,845.03	13,454.00	209,301.77	6,367.93	14,175.33	91.06 %
Shpenzime komunale	22,733.26	-	12,525.65	10,192.31	15,30	55.10 %
Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
<i>Gjithsej</i>	613,658.29	13,454.00	535,945.55	16,560.24	61,152.50	87.33 %



# Organogrami



**Organigrami i strukturës organizative pasqyron ndërvarësinë reciproke të strukturave dhe është miratuar me vendim të brendshëm të Avokatit të Popullit, si dhe definojnë qartë ndërtimin organizativ, si një parakusht për një funksionim të mirëfillt të institucionit, duke respektuar vertikalen hierarkike, si dhe duke krijuar hallkat e nevojshme të funksionimit horizontal.**

## Struktura organizative e IAP-së

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit, struktura e IAP-së përbëhet nga të zgjedhurit nga Kuvendi i Kosovës, si dhe nga nëpunësit civil të IAP-së, të cilët përzgjidhen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbim Civil.

Përzgjedhja e zëvendësve të avokatëve e në tetor 2011, ka ndihmuar në funksionalizimin e mëtutjeshëm organizativ, në pajtim me kërkesat dhe nevojat që janë identifikuar gjatë punës së përditshme.

Duke e konsideruar se të drejtat e njeriut nuk kërkojnë në mënyrë eksplicite vetëm përgatitje shkollore dhe profesionale, por gjithashtu edhe përkushtim njerëzor dhe gatishmëri për t'u përballur me situata të caktuara, që të shumtën e herave janë sfiduese dhe të vështira, punonjësit e IAP-së janë obliguar që të japin kontributin e tyre nëpër njësitë e krijuara, sipas fushave ku parashihet mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut.

Këto njësi janë grupuar në pesë departamente:

Departamenti i Gjyqësorit,

Departamenti i Ekzekutivit,

Departamenti i Kundër Diskriminimit,

Departamenti i Legjislacionit,

Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.

Departamentet udhëhiqen nga zëvendësit e Avokatit të Popullit, duke mundësuar kështu efektivitet dhe planifikim më të qartë e objektiva të arritshme.

## Donacionet e IAP-së, për vitin 2011<sup>1</sup>

Donatorët	Buxheti sipas kategorisë ekonomike	Shuma e buxhetit	Mjete të paalokuara	Mjete të shpenzuara	Mjete të pashlyera	Mjete të lira	Realizimi në %
Ambasada e Norvegjisë	Paga dhe mëditje	10,897.42	-	9,735.02	-	1,162.40	89,33 %
Ambasada e Norvegjisë	Mallra dhe shërbime	47,691.82	-	41,648.93	3,268.80	2,773.67	87,33 %
Ambasada e Turqisë	Mallra dhe shërbime	6,468.28	-	4,094.20	-	2,374.08	63,30 %
UNICEF-i	Mallra dhe shërbime	2,548.52	-	2,548.52	-	-	100,00%
PTK	Mallra dhe shërbime	2,981.00	-	2,981.00	-	-	100,00%
Ambasada e Belgjikës	Paga dhe mëditje	1,846.11	1,846.11	-	-	1,846.11	0 %
Ambasada e Belgjikës	Mallra dhe shërbime	721.20	721.20	-	-	721.20	0 %
	<b>Gjithsej</b>	<b>73,153.9</b>	<b>2,567.31</b>	<b>61,007.67</b>	<b>3,268.80</b>	<b>8,877.80</b>	<b>83,39%</b>

<sup>1</sup> Gjatë vitit 2011, IAP ka përfituar nga një seri aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve të stafit (p.sh. punëtori, tryeza të rumbullakëta, trajnime, vizita studimore, etj.) të financuara drejtpërsëdrejti nga OSBE. Donacionet e këtyre aktiviteteve (circa Euro 42,973) s'janë të përfshira në tabelën e mësipërme, sepse janë menaxhuar tërësisht nga donatori dhe jo IAP.

**Kontakti me Institucionin e Avokatit të Popullit**  
**e-mail adresa:**

[ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org](mailto:ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org)  
[info@ombudspersonkosovo.org](mailto:info@ombudspersonkosovo.org)

Thirrjet falas për palët:

**+381 (0) 38 223 780**

Adresa e Zyrës Qendrore:

**Institucioni i Avokatit të Popullit**

**Lagjja Bregu i Diellit,**

**Rr. "Enver Maloku", nr. 28**

**10000 Prishtinë, KOSOVË**

Puna me palë: e hënë – e premte, nga ora 08:00- 16:00

Tel: +381 (0) 223 782, +381 (0) 38 223 783,

+381 (0) 223 784, +381 (0) 38 223 789

Fax: +381 (0) 38 223 790

**Zyra në Prizren**

Adresa: Rr. "Remzi Ademi", pn

Tel: +381 (0)29 222 138

Puna me palë: Të hënë dhe të  
mërkurën, nga ora 10:00 -14:00

**Zyra në Pejë**

Adresa: Rruga "Mbretëresha

Teutë" Nr.59, Kati III, Nr. 3,  
Ndërtesa e Komunës

Tel: +381 (0)39 432 931

Puna me palë: Të hënë dhe të  
enjtën, nga ora 10:00 -14:00

**Zyra në Gjiilan**

Adresa: Rruga "Adem Jashari"

Ndërtesa e Komunës II

Tel: +381 (0)280 320 843

Puna me palë: Të hënë dhe të  
enjtën, nga ora 10:00 -14:00

**Zyra në Mitrovicë**

Adresa: Sheshi "Agim Hajrizi",

pn, Ndërtesa e Administ.

Rajonale Tatimore

Tel: +381 (0)28 530 138

Puna me palë: Të hënë dhe  
të enjtën, nga ora 10:00 -14:00

**Nën-zyra, Mitrovicë**

Adresa: Aneksi i Trepçës, Rr.

"Filip Visnjic" Nr. 4

Tel: + 377 (0)45 455 319 dhe

+381 (0)63 817 44 79

Puna me palë: Të hënë dhe të  
enjtën, nga ora 10:00 -14:00

**Zyra në Graçanicë**

Telefoni : +381 (0) 38 65 118

Tel. mobil: +377 (0) 44 367 719

+381 (0) 64 37 11 137

Puna me palë: Të hënë dhe të  
enjtën, nga ora 10:00 -14:00